



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit**  
**Drejtoria për Ekonomi e Financa**  
**Datë: 20 Maj 2021**  
**Prizren**

**DËGJIMI I TRETË PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE**  
**(KAB) 2022-2024**  
**“Takimi me përfaqësuesit e bizneseve”**

**P R O C E S V E R B A L**

**Debati i tretë (III) publik për pranimin e propozimeve dhe kërkesave eventuale për buxhet, projekte dhe shërbimet komunale për vitin e ardhshëm 2022, mbahet me përfaqësuesit e bizneseve të komunës sonë.**

Komuna e Prizrenit organizon katër dëgjime publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Në këto dëgjime mëtojmë të marrim opinionin e qytetarëve për projektet vijuese të komunës sonë, shërbimet komunale dhe kërkesat tjera eventuale.

**Vazhdon seria e dëgjimeve publike për pranimin e propozimeve dhe kërkesave të qytetarëve lidhur me projektet dhe shërbimet komunale!**

Më 20 maj (e enjte), në ora 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal u mbajt mbledhja e tretë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024, ku tema e këtij dëgjimi publik është **“Takimi me përfaqësuesit e bizneseve”**.

Për shkak të situatës pandemike, pjesëmarrja në këto takime do të jetë e kufizuar sipas distancës dhe hapësirës në sallë, ndërkaq për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje. Komuna jonë këto dëgjime publike do t'i organizojë edhe në formën “online” përmes aplikacionit ZOOM, nëpërmjet linkut:

<https://us02web.zoom.us/j/83369981356>  
Meeting ID: 833 6998 1356

Informacionet më të hollësishme në lidhje me dëgjimet publike dhe linqet për pjesëmarrje nëpërmjet platformës ZOOM mund të gjeni në:

Për gjuhë shqipe: <https://kk.rks-gov.net/.../04/Degjime-publike-KAB.pdf...>

Për gjuhën turke: <https://kk.rks-gov.net/.../26/2021/04/ORTA-VADELI-KAB.pdf...>

Për gjuhën srb/bosh.: <https://kk.rks-gov.net/.../JAVNE-DEBATE-O-SREDNJOROCNOM...>

Qytetarët dhe të tjerët të interesuar, informacione më të përimtuara për dëgjimet publike, linqet për pjesëmarrje përmes platformës ZOOM, orën dhe ditën e mbajtjes së dëgjimeve, në të gjitha gjuhët zyrtare i kemi bërë publike kohë më parë, në Ueb faqe të komunës, Facebook, Instagram, YouTube, TV- lokale, Radio Lokale, etj...

**Të ftuar:**

- Përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- Qytetarët,
- Organizatat Ndërkombëtare,
- Përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit,
- Përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve të Komunës së Prizrenit,
- Mediet lokale të Komunës së Prizrenit.

Dëgjimin e tretë publik me bizneset, e moderoi drejtoresha për Ekonomi e Financa znj. Leonora Çerreti, e cila fillimisht prezantoi planifikimet dhe parashikimet buxhetore të komunës sonë për vitin 2022.

Buxheti për vitin 2022 do të jetë 49.455.755.00 euro, 4 %, rritje krahasuar më vitin paraprak.

Linku i prezantimit: <https://www.youtube.com/watch?v=ocUmg3pj9LM>

Pas prezantimit të planifikimit të buxhetit për vitin vijues, drejtoresha znj. Leonorë Çerreti hap diskutimin me të pranishmit në sallë dhe ata të cilët përcillnin debatin online.

Bujar Bilurdagi:

Përshëndetje, kërkoj rregullimin e parkingut afër komunës, për momentin parkingu shfrytëzohet vetëm nga bizneset e duhet të jetë i destinuar për klientët tanë.

Mundësisht edhe kah Marashi është mirë me pas një parking. Parkingjet duhet të ndahen sipas kategorive të biznesit. Parkingu këtu afër komunës duhet të jetë vetëm për konsumatorët, biznesmenët nga shtëpia të vijnë në këmbë në punën e tyre.

E dyta: Të bëhet riorganizimi i një qendre zejtare, p.sh një zejtar profesional floktar, rrobaqepës, argjendar etj...

E treta rruga kah Marashi frekuentohet shumë dhe është shumë e dëmtuar, duhet të mirëmbahet. Ura e Marashit po ashtu duhet të mirëmbahet ngase një ditë ka me u rrezuar.

Haki Reshtana :

Së pari ju përshëndes që na mundësuar rregullimin e trotuarit në lagjen tonë, në lagjen "Tabakhane" jetoj dhe deri tani kemi realizuar shumë projekte me komunën dhe jam falënderues.

Valdet Hoxha avokat:

Në këtë dëgjim publik përfaqësoj një biznes: A parashihen në buxhet investime në parkun e biznesit dhe çka do të bëhet me pronaret që operojnë me biznes në këtë park?

Resmije Krasniqi :

Komuna mi ka prish dy dyqane dhe kërkoj nga komuna të na jep një dyqan në emër të shoqatës sonë që t'i mbulojmë shpenzimet sa do pak. Nëse ka mundësi një shtëpizë të drurit me na e dhanë për shoqatën "Hader", të ura në qytet për shitjen e produkteve të anëtarëve të shoqatës sonë.

Sevil Kazazi

Nga viti 2019 nga komuna ka restauruar qendrën për zanatlijnë.

Ne "Bazhdarhane", do e rregullojmë një qendër për artizanale .

Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, ka të ndarë një buxhet prej 20.000 euro, për rregullimin e rrugës nga Marashi në drejtim të Kalasë

Sa i përket projektit të dylbive, jemi në dijeni për telashet dhe do të kërkoj nga operatori ekonomik që të bëjë rregullimet e nevojshme.

Funksionalizimi i parkut të biznesit: Neve si komunë na duhen edhe disa aprovime nga qeveria për funksionalizimin e tij, tash jemi duke bërë studimin e fizibilitetit dhe besoj së gjatë këtij viti do ta funksionalizojmë.

Znj. Resmije, shtëpizat e drurit jepen në baze të kërkesave dhe besoj se te gjithë aplikuesit do të shfrytëzojnë këto shtëpiza. Për këtë projekt nga QRTK-ja, na duhet leja dhe kur te kemi lejen do behet shpërndarja e tyre.

Në qendrën tone mund të ekspozoni produktet tuaja dhe nëse keni ndonjë propozim tjetër jemi te gatshëm te ju dëgjojmë.

Leonora Çerreti:

Bizneset e kanë derën hapur për kërkesa në drejtori.

Visar Shehu:

Ne mendojmë se parkingu afër Shtëpisë së Bardhë duhet të bëhet me pagese, por shuma do të jetë simbolike.

Po shohim mundësit, se si mund të shfrytëzohet sa me mire për të gjithë.

Per momentin jemi duke punuar për katër parkingje të reja në qytetet, të cilat do të rregullohen dhe do jenë pa pagese sigurisht. Punimet për parkingje do fillojnë shumë shpejte.

Për qendrën zeytare qe japin shërbime jemi te interesuar por nuk mund t'i japim blanko askujt leje jashtë procedurave ligjore. Shoqatat dhe bizneset duhet të bëjnë fillimisht një projekt dhe pastaj të kërkojnë leje nga komuna. Me projekt besoj se gjejmë zgjidhje për këtë çështje.

Te dylbitë ende nuk është bërë pranimi teknik dhe do kërkoj nga operatori qe t'i rregulloj te gjitha obligimet e punës të parapara me kontratë dhe gjetjet tjera eventuale, për ta siguruar qëndrueshmërinë e projektit.

Për shtëpitë e drurit jemi ne procedure te lejeve për shfrytëzim. Ky projekt është i përkohshëm dhe nuk do jete i përhershëm.

Te ura e Arastës do ketë mundësi për tregje të vogla mobile në formë të shtandave.

Përgjigje znj. Ergyl: Hapjen e rrugëve në zonën industriale e kemi filluar, ky projekt nuk ka përfunduar dhe te gjitha telashet eventuale do te rregullohen. Këtë vit është e planifikuar vetëm hapja e rrugëve.

Ergyli:

Punojmë më zhgun dhe ndoshta do kemi përparësi për këto shtëpiza ngase vetëm me këtë artizanat merremi.

Visar shehu

Sigurisht se do keni përparësi ju që merreni me artizanale.

Lumturije Gashi

Jam rrobaqepëse por nuk kam marrë asnjë pagese edhe pse kam aplikuar për grante në komunë.

Leonora Çerreti

E nderuar, për të përfituar kanë qenë disa kritere dhe në baze të tyre janë shpallur përfituesit, arsye e mos përfitimit tuaj sigurisht ka qene mungesa e dokumenteve apo që keni pas obligime ndaj komunës.

Sibel Vezaj Pirana:

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen. Do të kemi edhe një takim të fundit, më 31 maj, në ora 17:00.

Ju mirëpresim!